



Zyra Qendrore, Rr. Xh. Bush #26,10000 Prishtinë,Kosovë

FTESË PËR OFERTË
Ref no: T-0015-09-2025

Banka ProCredit fton të gjitha kompanitë e interesuara të paraqesin dokumentet e tyre për:

T-0015-09-2025 -Transporti i Parasë se Gatshme, Shërbime të Sigurisë Fizike, Njësitet patrulluese me veturë, Transporti i parasë se gatshme nga klienti ne bankë.

Banka ProCredit fton të gjitha kompanitë e interesuara dhe të kualifikuara të paraqesin dokumentacionin e tyre për pjesëmarrje në tenderin e ndarë në katër LOT-e, përkatësisht:

LOT 1: Transporti i Parasë se Gatshme, mbushja dhe zbraze e ATM-ve, zbraze e Dropbox-ve si dhe Transport i parave të dyshimta.

LOT 2: Shërbime të Sigurisë Fizike për Objektet e ProCredit Bank.

LOT 3: Njësitet patrulluese me veturë

LOT 4: Transporti i parasë së gatshme nga klienti

Gjatë fazës së parë të tenderit, kërkohet dorëzimi i dokumentacionit bazë për vlerësim të përmbushjes së kërkesave të bankës për shërbimet e lartpërmendura. Vetëm subjektet që kualifikohen në këtë fazë do të ftohen të marrin pjesë në fazën e dytë, ku do të kërkohet nënshkrimi i një marrëveshjeje konfidencialiteti (NDA). Pas nënshkrimit, banka do të dërgojë dosjen e plotë të tenderit.

Në fazën e parë, kompania e interesuar për ofertim duhet të dërgojë dokumentacionet e mëposhtme:

- Historiku i Shkurtër i Kompanisë
- Struktura Organizative e Kompanisë
- Licencat nga Ministria e Punëve të brendshme për ofrim të shërbimeve private të sigurisë,
- Leje për ofrimin e shërbimit të transportit të parave të gatshme dhe sendeve me vlerë,
- Lista e Kompanive që ju ofroni shërbimin CIT (Cash in Transit), Mbushje /Zbraze të AMT-ve, Roje/Sigurim, Patrullim dhe Transportim/Dërgim/Bartje të Bankënotave të dyshuara për falsifikim.

Për qëllime informimi, kompanitë mund të kërkojnë dokumentin me informata shtesë për secilin LOT, i cili përmban informata që duhet të merren parasysh gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit për Fazën 2. Kompanitë duhet të kenë parasysh që:

- Kërkesa për informata shtesë duhet të dërgohet në: kos.procurement@procredit-group.com.
- Dorëzimi i dëshmive për kërkesat e listuara në shtojcën me informata shtesë nuk është i nevojshëm në këtë fazë. Ato shërbejnë vetëm për informim paraprak.

Palët e interesuara për pjesëmarrje në këtë tender fillimisht duhet të dorëzojnë dokumentet bazë për aplikim sipas kërkesës me lartë, prej datës 21/10/2025 deri më 27/10/2025 në ora 15:00 në e-mail adresën kos.offers@procredit-group.com. Në subjektin e-mailit duhet të shënohet qartë **T-0015-09-2025 - Transporti i Parasë se Gatshme, Shërbime të Sigurisë Fizike, Njësitet patrulluese me veturë, Transporti i parasë se gatshme nga klienti ne banke**. Gjithashtu, specifikoni qartë nëse aplikoni për LOT 1, LOT 2, LOT 3, LOT 4 apo për me shumë se një lot.

Vërejtje:

- Banka ProCredit mban të drejtën të kërkojë informata shtesë nga kompanitë e kualifikuara për ofertim.



ProCredit Bank

Zyra Qendrore, Rr. Xh. Bush #26,10000 Prishtinë,Kosovë

- Kompanitë ofertuese duhet të kenë minimumi 3 vite përvojë pune për shërbime private të sigurisë.
- Banka ProCredit ka të drejtë të anulojë tenderin dhe/ose ndryshojë karakteristikat e tenderit dhe t'i ftojë pjesëmarrësit për të sjellur sërish ofertat e tyre.
- Asnjë shpenzim që e bëni gjatë përgatitjes dhe dorëzimit dosjeve nuk kompensohet.

Çdo pyetje shtesë rreth kësaj ftese për ofertë mund ta adresoni në :

kos.procurement@procredit-group.com

